Vendim nr. 311, datë 02.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 02.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE:	**SHOQËRIA "DOCI – KIJOV" SH.P.K.,** përfaqësuar nga avokati Arben Kujosa, me prokurë të posaçme.
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4058, datë 10.11.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.** **Dërgimi për gjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 18, pika 1, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik tregtar i regjistruar në QKB me NUIS L31610007C, në Paskuqan, Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në fushën e pastrim gjelbërimit të territorit, tregtimit të karburanteve, ndërtim ujësjellës-kanalizimeve etj. Midis Komunës Paskuqan dhe shoqërive kontraktuese si bashkim i përkohshëm "I." sh.p.k. & "Sh." sh.p.k., në datën 19.06.2012 është lidhur kontrata e sipërmarrjes, me objekt "Evadimin e mbetjeve urbane në Komunën Paskuqan" në vlerën 29.218.894 (njëzet e nëntë milionë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, me afat 30 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Në datën 11.04.2013, shoqëritë "I." sh.p.k. & "Sh." sh.p.k. kanë lidhur kontratë nënsipërmarrjeje me kërkuesen, për implementimin e kontratës së sipërpërmendur, sipas së cilës afati i mbetur i kontratës së sipërmarrjes i mbetet asaj në cilësinë e nënkontraktorit, dhe kjo e fundit do të realizojë shërbimet me punonjës të saj. Kontrata është autentifikuar në nënshkrimet e subjekteve përpara noterit dhe është miratuar të nesërmen e nënshkrimit të saj nga autoriteti kontraktor Komuna Paskuqan, me shkresën e kësaj të fundit me nr. 686/1 prot., datë 12.4.2013.

2. Në vijim, në datën 17.12.2013, midis "I." sh.p.k. kërkueses dhe "Sh." sh.p.k. është lidhur aktmarrëveshja nr. 17532 rep., dhe 13452 kol., përpara noterit, me të cilën, shoqëritë "I." sh.p.k. dhe "Sh." sh.p.k. kanë deklaruar se heqin dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë të bëjnë me punimet sipas dy kontratave të sipërpërmendura dhe se të gjitha këto të drejta dhe detyrime i kalojnë kërkueses. Shërbimi i kontraktuar ka përfunduar efektet e tij 30 muaj nga lidhja e kontratës më 31.12.2014, dhe më pas, vetëm në datën 02.02.2015, Komuna Paskuqan ka lidhur kontratë tjetër sipërmarrjeje me kontraktuesit "Sh." sh.p.k. dhe kërkueses, me objekt "Kryerja e shërbimit të pastrimit në territorin e Komunës Paskuqan", me afat 12 muaj, paraprirë nga kontrata për bashkimin e përkohshëm të të dyja shoqërive, datë 15.01.2015.

3. Në datën 11.12.2015 kërkuesja i është drejtuar Bashkisë së Kamzës me kërkesë për të bërë të mundur likuidimin e vlerës prej 1.792.800 lekësh për pastrimin e mbetjeve urbane në ish-Komunën Paskuqan (bërë pjesë e Bashkisë së Kamzës), me arsyetimin se kjo është një punë e kryer nga ana e kësaj shoqërie si operator ekonomik. Bashkëlidhur kërkesës, shoqëria ka përcjellë situacionin për muajin janar 2015. Bashkia e Kamzës, me shkresën "Kthim përgjigjeje" nr. 4232/1 prot., datë 28.01.2016, ka sqaruar kërkuesen se ish-Komuna Paskuqan ka lidhur me ta kontratën e sipërmarrjes nr. 321 prot., datë 02.02.2015, për kryerjen e shërbimit të pastrimit në territorin e ish-Komunës Paskuqan dhe se nga bilancet e pasqyrat financiare të dorëzuara nga ish-Komuna Paskuqan, pas amalgamimit me Bashkinë e Kamzës, rezulton se ish-Komuna Paskuqan nuk është debitore ndaj kërkueses për muajin janar 2015".

4. Kërkuesja për këtë problematikë i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke paditur Bashkinë e Kamzës, me objekt detyrimin e saj për t'i paguar shumën 1.792.800 lekë, si vlerë e papaguar, për punën e kryer për evadimin e mbetjeve urbane të ish-Komunës Paskuqan, për muajin janar 2015. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 832, datë 02.02.2018, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1512, datë 23.04.2018, ka vendosur pranimin e padisë së kërkueses dhe detyrimin e palës së paditur, Bashkinë e Kamzës, t'i paguajë paditësit shumën 1.792.800 lekë, si vlerë e papaguar, për punën e kryer për evadimin e mbetjeve urbane të ish-Komunës Paskuqan në atë kohë, për muajin janar 2015. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim Bashkia e Kamzës.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 937 (86-2025-1156), datë 26.05.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1512, datë 23.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Për rekursin e kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-4058, datë 10.11.2025, ka vendosur mospranimin e tij, pasi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*.

7. Në datën 06.05.2026 (sipas shërbimit postar) kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 08.06.2026. Në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkueses

8. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur,* pasi nga gjykata e apelit asaj nuk i është komunikuar ankimi palës së paditur për vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Po kështu, kërkuesja nuk është njoftuar as për datën dhe orën e gjykimit në dhomën e këshillimit, ndërkohë që në gjykatën e apelit gjykimi është vonuar për afro 7 vjet. Në këtë mënyrë, ajo është privuar nga e drejta për të paraqitur apel kundërshtues, për rrjedhojë i është cenuar e drejta e mbrojtjes. Gjithashtu edhe vendimi për ta gjykuar çështjen në gjykatën e apelit në dhomën e këshillimit ka qenë i papërshtatshëm dhe jo

shterues, duke lejuar që provat dhe faktet të mos i nënshtrohen analizës. Këto të meta në gjykimin në gjykatën e apelit nuk janë konstatuar dhe as janë ndrequr nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

9. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Për sa u takon kritereve të pranueshmërisë së kërkesës kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në këtë kuptim, gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Prandaj, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kritereve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare *(shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve).*

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi

ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit *(shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Lidhur me llogaritjen e afatit të ankimit kushtetues individual, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se duhet shpjeguar mënyra në të cilën individi mund të sigurojë provën e datës së njoftimit ose përse vetëm individi duhet të ketë barrën e provës në këtë drejtim. Sipas asaj gjykate, i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahimi dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.01.2025, § 13*).

12. Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 11, datë 21.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, sipas Gjykatës, ndonëse aksesi në gjykatë është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit, ai mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 42, datë 22.12.2022; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Përcaktimi i afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i tyre do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 29, datë 15.05.2014; nr. 5, datë 02.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 10.11.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 06.05.2026 (sipas shërbimit postar). Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë, e cila në datën 22.06.2026 ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 21.11.2025. Gjithashtu, nga ana e asaj gjykate është sqaruar edhe fakti se palët janë njoftuar nominalisht në datën 25.11.2025, nëpërmjet adresave elektronike, duke vënë në dispozicion edhe kopje të *e-mail*-it që e vërteton këtë fakt. Nga ana e kërkueses, në ankimin kushtetues individual është

parashtruar se ajo ka ardhur në dijeni të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në datën 17.04.2026, pasi e ka tërhequr vendimin në sekretarinë e asaj gjykate.

14. Ndodhur në këto kushte, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është investuar nga kërkuesja nëpërmjet rekursit, e përfaqësuar me avokat, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit që kishte ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e rrëzuar kërkesëpadinë e saj, rrethanë kjo që tregon se ajo kishte interesin dhe mundësitë, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë, për të ndjekur fatin e rekursit të saj. Ndërkohë që nga ana e Gjykatës së Lartë është provuar se është njoftuar në rrugë elektronike në adresën arbenkujosa@gmail.com mbrojtësi i saj me prokurë, i cili e ka përfaqësuar në paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë dhe e përfaqëson edhe aktualisht në paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Nga këto fakte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkueses është dorëzuar në gjykatë rreth një muaj e gjysmë, tej afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.